



ARSIMI I LARTË PRIVAT NË KOSOVË

SA KA PERFITUAR SHOQËRIA KOSOVARE NGA HAPJA E UNIVERSITETEVE PRIVATE?

Përgatiti: BJONDINA REXHA

PRISHTINË, GUSHT 2013

Hyrje

Që nga viti 2001, 30¹ institucione të ndryshme kanë marrë licencën për punë, përderisa 19² prej tyre janë të licencuara në vitin 2012. Nga rreth 26000³ nxënës sa dalin nga niveli sekondar i shkollimit në Kosovë, 16000⁴ shkojnë në UP dhe pjesa tjetër 10000 absorbohen nga universitetet private. Nga këto universitete shumica ofrojnë programe të njëjta, si përshembull Juridik, Ekonomi, Kriminalistike , por, mund të vërejmë mungesën e programeve nga shkencat ekzakte. Fatkeqësisht, Kosova nuk ka një mekanizëm që përshtatë kërkesën e tregut për kualifikimet (llojin dhe sasinë) e të diplomuarve me ofertën e atyre që dalin nga UP-ja dhe Universitetet Private. Poashtu, gjatë këtij viti procesi i akreditimit ka rezultuar që të gjitha këto “universitete” në fakt nuk mund të quhen universitete pasi që nuk i kanë përmbushur rregullat që të quhen universitete. Këto rregulla parashohin që të ketë rreth 3000 studentë, 5 fakultete me programe të ndryshme me së paku 600⁵ studentë për secilin fakultet, prandaj ato mund të quhen vetëm kolegje. Pra, në këtë punim paraqitet se si janë hapur këto institucione, gjendja e tyre aktuale dhe cilat janë masat që duhet të ndërmerren.

Përmbajtja

Mungesa e kriterëve për regjistrimin e institucioneve për arsim të lartë ka rezultuar me një numër të lartë themelimesh të institucioneve të tilla. Ato janë licencuar pa qartësuar procedurat paraprake për akreditim dhe licencim. Madje, deri në fillim të vitit 2008, Ministria e Arsimit, nuk ka inspektuar asnjë nga këto institucione, kur u themelua Agjensioni i Akreditimit të Kosovës (AAK), i cili kishte për detyrë të bëjë vlerësimin e cilësisë në këto institucione.

¹ Instituti Gap për studime të avancuara, “Pasqyrë e Arsimit të Lartë Privat në Kosovë”, (fq.3),2008.

² Radio Evropa e Lirë, “Numri i Universiteteve Private është shumë i madh”, 2006.
<http://www.evropaelire.org/articleprintvieë/1000240.html>

³ Portali Koha, “Kosova prodhon kuadro në shpërputhje me nevojat e tregut të punës”
<http://www.koha.net/?page=1,13,113887>

⁴ Ibid.

⁵ Gap, (fq.4).

Kjo ngecje e institucioneve të Kosovës, bëri që këto universitete private të marrin karakter fitimprures dhe të cilësojnë universitetin si një vend biznesi e jo si një tempull të dijes. Gjatë vitit 2013, procesi i akreditimit, me ndryshimin e emërtimeve të institucioneve ka siguruar vazhdimin e punës së universiteteve private që të quhen edhe më tej kolegje. Ferdije Zhushi- Etemi, drejtoreshë e Këshillit Kombëtar të Cilësisë, ka thënë se asnjë nga kolegjet private që veprojnë në Kosovë nuk i kanë arritur kriteret e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë që të akreditohen universitete.⁶ Ky ri-akreditim i institucioneve private si kolegje është një dëshmi për cilësinë që ofrojnë këto kolegje, dhe se ato janë më shumë institucione të profitit se sa të cilësisë.⁷ Mirëpo, në anën tjetër edhe në urdhëresën administrative nr. 14/2003 të lëshuar nga MASHT për licencimin e bartësve të arsimit të lartë, nuk janë specifikuar qartë kriteret për licencimin e bartësve private të arsimit të lartë dhe gjithashtu këto kritere janë subjektive. Po ashtu kriteri i rëndësishëm për licencim është edhe lista e profesorëve dhe kualifikimet e tyre të cilat duhet t'i dorzohën MASHT-it.⁸ Në këtë urdhëresë nuk është specifikuar poashtu proporcioni i profesorëve me diploma, apo, hapësira specifike e objektit të bartësve privat, nuk ka ndonjë numër të dhënë për klasa të ligjeratave dhe amfiteatrove në proporcion studentë-klasë, bibliotekë me inventar dhe numër të pasur të librave të fushave të ndryshme, laboratore dhe pajisje të nevojshme të punës.⁹ Gjithashtu, Qeveria ka shkelur ligjin gjatë procesit të Akreditimit, pasi që akreditimi duhet të bëhet nga agjensioni për akreditim i Kosovës e jo nga MASHT-i. Ligji thotë që procesi i akreditimit i takon Agjencionit për Akreditim ndërsa, ai për licencim i takon MASHT-it.¹⁰

⁶ Portali Indeksonline, " Universitetet private mbesin kolegje",
<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=63852>

⁷ Ibid.

⁸ Instituti Gap per studime të avancuara, " Pasqyrë e Arsimit të Lartë Privat në Kosovë", (fq.6).

⁹ Gap, (fq.6).

http://www.institutigap.org/documents/43587_Pasqyre_e_Arsimit_C3AB_LartCAB_nC3AB_KosovC3AB.pdf

¹⁰ Monitorim i Procesit te Licencimit dhe Akreditimit te BPrAL, "Shkelja e ligjit nga ana e Qeverise", (fq.6-7). http://www.cohu.org/repository/docs/Akreditimi_i_Universiteteve_Private_final_157923.pdf

Poashtu, gabimi që bëhet në mos dallimin në mes licencimit dhe akreditimit, ku licencim do të thotë leje pune, dhe ajo duhet të bëhet para akreditimit.¹¹ Ministria ka ngecur edhe në metodologjinë e përdorur për vlerësimin e këtyre institucioneve, duke bërë pyetësor që nuk janë adekuat dhe nuk mund të nxirrej një vlerësim rreth përmbushjes së obligimeve të këtyre institucioneve , dhe gjendjen ekzistuese të tyre.¹² Një çështje shumë shqetësuese është edhe tendenca për politizimin e insitucioneve private që nga fillimi i akreditimit dhe licencimit të tyre. Këto ndërhyrje politike dhe konflikte interesi, mungesa e kuadrit të plotë ligjor dhe kritereve të qarta për akreditim dhe licencim, shkelje ligjore nga qeveria me rastin e themelimit të Komisionit të Akreditimit, metodologjia e mangët dhe koha e pakët, lënë hapësire që i tërë procesi i “akreditimit”, të jetë subjektiv nga ana e MASHT-it, dhe përfundimisht i korrupsuar në licencimin dhe akreditimin e institucioneve private.¹³ Në Kosovë kemi një numër të madh të të interesuarve për të vazhduar shkollimin në nivelin e universitetit. Por, shtrohet pyetja se qka po i shtynë ata të vazhdojnë? Disa nga arsyet sipas një hulumtimi janë:

Papunësia: Duke u nisur nga niveli i papunësisë rreth 44%, një ndër mundësitë është që të kenë një diplomë me shpresë që të rritet mundësia për punë.

Universiteti i Prishtinës: Pasi që UP-ja nuk arrinë që t’i absorbojë të gjithë studentët, ata mundësi të dytë shohin Universitetet Private.

Mundësia për të studiuar në një universitet më të mirë: Ata qe kanë mundësi më të mira financiare kërkojnë kushte më të mira për të studiuar, arsim më cilësor, profesorë më të motivuar të cilët janë më të paguar se në UP.

¹¹ Monitorim i Procesit të Licencimit dhe Akreditimit të BPrAL, “ Mungesa e kritereve dhe procedurave të qarta për akreditim”, (fq.7-8).

¹² Monitorim i Procesit të Licencimit dhe Akreditimit të BPrAL, “ Metodologjia e përdorur nga ana e MASHT-it”, (fq.8-9).

¹³ Monitorim i Procesit të Licencimit dhe Akreditimit të “Ndërhyrjet politike në procesin e licencimit dhe akreditimit”, (fq.9-10)

Mirëpo, ky raport nuk ka analizuar cilësinë e mësimave dhe lëndeve të ofruara në këto universitete, synimi për një arsim më të mirë është ajo që i shtynë këta studentë të zgjedhin universitetet private.

Ore mësimore fleksibile: Për të tërhequr studentët që punojnë, universitetet private ofrojnë mënyra fleksibile të studimeve, ligjerata në orë të mbrëmjes deri te opsionet fleksibile të provimeve.

Fokusimi në diplomë: Kur papunësia në vend është e madhe, kërkesa për një vend pune është e madhe. Diploma universitare bëhet parakusht për pothuajse çdo vend pune. Për këtë arsye, njerëzit dëshirojnë vetëm të arrijnë deri tek diploma që të ju figurojë në CV-në e tyre. Pra, vëmendja përqendrohet në nivelin e arsimit e jo në cilësinë e arsimit që ata marrin në këto institucione.¹⁴

Mirëpo, nga këta të diplomuar që ka Kosova një pjesë e konsiderueshme e tyre si nga universiteti publik, poashtu, edhe atyre privat, ata nuk janë të përgatitur për tregun e punës. Kjo ndodh sepse punëkërkesve ju mungon puna praktike, ose disa që kanë kryer studimet më herët, ju mungojnë trajnimet pasi teknologjia ka avancuar.¹⁵ Prurjet e reja teknologjike janë shkathtësi të cilat universtetet tona nuk ua mësojnë studentëve, dhe prandaj atëherë kemi të diplomuar, por të pafatë për tregun e punës.¹⁶ Pastaj, duhet të marrim parasysh se tregu ynë është i vogël dhe nuk mund ti absorbojë të gjithë të diplomuarit, kështu që ne duhet të kemi, poashtu, njerëz të aftë edhe për tregun e gjerë, si psh., atë evropian.¹⁷

¹⁴ Instituti Gap për studime të avancuara, “ Pasqyrë e Arsimit të Lartë Privat në Kosove”, (fq.14).

¹⁵ Portali Telegrafi, “ Me diploma, por te paprgatitur per pune” <http://www.telegrafi.com/ekonomi/me-diploma-por-te-papergatitur-per-pune-46-14978.html>

¹⁶ Ibid.

¹⁷ <http://www.telegrafi.com/ekonomi/me-diploma-por-te-papergatitur-per-pune-46-14978.html>

Konkluzioni

Duke u nisur nga gjërat e lartpërmendura mund të themi që hapja e universiteteve private nuk ka sjellur ndonjë risi për nga ana e cilësisë, mundësive të reja, apo avancimit. Që nga hapja këto universitete janë përcjellur me një varg parregullësish, si përshembull nga procesi i Akreditimit. Përderisa këto institucione të cilat nuk kanë arritur as të quhen universitete, shoqëria kosovare nuk po merr atë që i duhet një shkollim cilësor ku ajo do të ishte e përgatitur si për tregun kosovar ashtu edhe atë jashtë saj. Prandaj, unë rekomandoj që:

1. Qeveria e Kosovës të punojë rreth një strategjie se sa dhe cfarë kuadro i duhen ekonomisë kosovare.
2. Të inkurajohet hapja e fakulteteve të shkencave ekzakte, në mënyrë që të mos kemi vetëm programe nga ekonomiku apo juridiku.
3. Të sigurohet që arsimimi që mirret nga këto institucione të jetë përkitazi me nevojat e tregut, duke ndërmarrë trajnimet e nevojshme me teknologjinë në avancim.
4. Të ndalohet politizimi i Institucioneve Private dhe të dënohen ata që mundohen ta bëjnë këtë.

Lista e referencave:

Instituti Gap për studime të avancuara, “ Pasqyrë e Arsimit të Lartë Privat në Kosove”, 2008.

http://www.institutigap.org/documents/43587_Pasqyre_e_Arsimit_C3AB_LartCAB_nC3AB_KosovC3AB.pdf

Monitorim i Procesit të Licencimit dhe Akreditimit të BPrAL,

http://www.cohu.org/repository/docs/Akreditimi_i_Universiteteve_Private_final_157923.pdf

Me diploma por të papërgatitur për punë. Telegrafi.com. Qershor 16, 2013.

<http://www.telegrafi.com/ekonomi/me-diploma-por-te-papergatitur-per-pune-46-14978.html>

(accessed Korrik 25, 2013)

Universitetet private mbesin kolegje. Indeksonline.net. Korrik 5, 2013.

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=63852> (accessed Korrik 6,2013)

Kosova prodhon kuadro në shpërputhje me nevojat e tregut të punës. Koha.net. Shtator 4, 2012.

<http://www.koha.net/?page=1,13,113887>

Numri i Universiteteve Private në Kosovë është shumë i madh.evropelire.org. Mars 10, 2006.

<http://www.evropaelire.org/articleprintview/1000240.html> (accessed Gusht 5,2013)